



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 36-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 24.06.2021, në Qendrën Rinore në Janjevë, me fillim në ora 14,⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Skender Bikliqi, Kryesues i Komitetit për Komunitete
2. Lulzim Rrustemi
3. Naxhije Gashi
4. Arben Salihu
5. Slavisa Trajkovic
6. Zoran Çirković
7. Franjo Goleme

Të tjerë prezent

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Lulzim Qerimi, nënkryetar i Komunës
3. Shaban Sylja, shef i sektorit për BF
4. Emilie Digrazia OSBE
5. Lindia Jovanovic-ZLK
6. Naser Bytyqi, përkthyes shqip-sherbisht
7. Merita Bytyqi, përkthyes shqip-sherbisht
8. Arben Koshi OSBE
9. Dhe një grup tjetër i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Skender Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se rendin e ditës e keni marrë dhe pyeti a ka dikush vërejtje apo plotësime?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht aprovoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 35-të e Komitetit për Komunitete.
2. Raporti për kornizën afatmesme buxhetore

3. Raporti i ZLK-s
4. Të ndryshme
5. Pastaj kryesuesi pyeti a ka vërejtje apo plotësime me qe nuk pati vërejtje as plotësime kryesuesi e hodhi ne votim rendin e ditës se propozuar dhe me te gjitha votat prezentë kaloi.

Pastaj Kryesuesi ia kaloi fjalën përfaqësueses së OSBE-s Emilie Digrazia e cila tha se ne jemi falënderues për bashkëpunimin qe kemi pas me juve po ashtu po ashtu i falënderoj edhe përfaqësuesit tone Arbenin dhe Laurasin për punën qe po e bëjnë dhe presim qe te vazhdojmë te kemi bashkëpunim.

Skender Bikliqi,edhe ne jemi falënderues për bashkëpunimin qe kemi pas si komitet dhe presim qe te vazhdojmë te kemi bashkëpunim edhe ne te ardhmen.
Pastaj u kalua me piken e parë te rendit te ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 35-të të Komitetit për Komunitete

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush vërejtje, apo plotësime, në ekstraktin nga mbledhja e 35-të?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi të njëjtin e vuri në votim dhe pas votimit, konstatoi se Komiteti unanimisht.

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 35-të të Komitetit për Komunitete

Shtesë: Ekstrakti.

II

Raport nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje sociale mbi gjendjen sociale të komuniteteve

II

Raporti per kornizen afatmesme buxhetore

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi,ia kaloj fjalën Shaban Sylës nga DBF e cila në pika të shkurta i njoftoi rreth raportit për kornizën afatmesme buxhetore

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin,

Daut Azemi,tha se janë mbajt disa dëgjime buxhetore po ashtu edhe unë si kryesues i kam mbajte dy dëgjime buxhetore,me anëtarët e Kuvendit-KPF-s Komitetit për Komitete dhe grupet e qytetarëve,OJQ-ve dhe Kryetarët e këshillave te fshatrave.

Me qe diskutime tjera nuk pati u kalua në pikën ne vazhdim.

III

Raporti i punës së ZLK-së

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Skender Bikliqi, ia kaloi fjalën Lidija Jovanovic nga ZLK e cila në pika të shkurta i njoftoi rreth Raporti i punës së ZLK-së

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin,

Zoran Cirkovic, jam i kënaqur me raportin e ZLK-s, që po na informon çdo mbledhje. Është mirë që koka rritet pak buxheti i ZLK-së, po ka nevojë ende të rritet. Kam një pyetje për konkurset për vendet e liruara të punës, të personave që janë pensionuar a do të ketë ndonjë konkurs për tu plotësuar ato vende.

Lidija Jovanovic, tha se neve kryetari për këtë vit na ka pritur një shumë për rritjen e buxhetit për ZLK. Ndërsa sa i përket vendeve të lira të punës ende ministria nuk i kam leju.

Daut Azemi, kryesuesi i Kuvendit, tha se ne kemi dikur 30 vende të lira por nuk po na lejohet nga ministria ti shpallim ato vende edhe pse kryetari i komunës ka bërë kërkesë disa herë.

Naim Jahiri, ju falënderoj të gjithëve për punën që po e bëni po ashtu ju uroj për qendrën rinore e gëzofshi. Shpresojmë që të ketë rritje të buxhetit për ZLK-n.

IV

Të ndryshme

Skender Bikliqi, unë edhe një herë ju falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin po ashtu e falënderoj ekzekutivin për punën që po e bënë, por ka nevojë edhe për disa punë që të bëhen në Janjevë.

Daut Azemi, tha se edhe ne jemi të kënaqur me bashkëpunimin që kemi pasur me juve si komitet po ashtu jemi të kënaqur me punët që janë bërë në Janjevë dhe do të vazhdojmë me punë edhe në të ardhmen.

Lulzim Qerimi edhe na jemi të kangur me punën që kemi bërë si Komitet tash pritet që edhe në Gadime të kemi një Qendër të njëjtë si në Jajevë, ku do të jetë në këtë mbledhje të kuvendit si pikë e cila do të jetë në shërbim të qytetarëve.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 14⁵⁰.

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit
Skender Bikliqi